

Ligji nr. 69, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 56, datë 28.05.2015 dhe me ligjin nr. 48, datë 23.07.2018

| Baza ligjore | Përshkruesit praktikë | Po/jo | Komente |
|-------------------------|---|--------------|----------------|
| Kreu I, Neni 5, Pika 1 | Shtetasve shqiptarë, të huaj dhe pa shtetësi u garantohet e drejta për arsimim, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike, fetare, gjendja ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar etj. | | |
| Kreu I, Neni 5, Pika 2 | Në shkollat publike arsimit i detyrueshëm dhe arsimit i mesëm i lartë janë falas. | | |
| Kreu I, Neni 6, Pika 1 | Në veprimtaritë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, interesi i nxënësit është parësor. | | |
| Kreu I, Neni 6, Pika 2 | Në sistemin arsimor parauniversitar respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat e liritë e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti. | | |
| Kreu I, Neni 6, Pika 3 | Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral. | | |
| Kreu I, Neni 6, Pika 4 | Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve. | | |
| Kreu I, Neni 6, Pika/ 5 | Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim. | | |
| Kreu I, Neni 6, Pika 6 | Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj. | | |
| Kreu I, Neni 6, Pika 7 | Veprimtaria e institucioneve në sistemin arsimor parauniversitar dhe e punonjësve të tyre është transparente dhe e bazuar në llogaridhënie ndaj përfituesve të shërbimit arsimor. | | |
| Kreu I, Neni 6, Pika 8 | Në sistemin arsimor parauniversitar garantohet e drejta e nxënësve, e punonjësve arsimorë, e prindërve dhe përfaqësuesve të tyre ligjorë, më poshtë “prindër”, për të shprehur pikëpamjet e tyre për cilësinë e shërbimit arsimor dhe për t’u dëgjuar për këto pikëpamje. | | |
| Kreu I, Neni 6, Pika 9 | Sistemi arsimor parauniversitar funksionon mbi bazën e decentralizimit dhe autonomisë së institucioneve arsimore. | | |
| Kreu I, Neni 6, Pika 10 | Në sistemin arsimor parauniversitar garantohet e drejta e organizimit të nxënësve, mësuesve dhe prindërve për të mbrojtur të drejtat e tyre, si dhe për të dhënë ndihmesë në mbarëvajtjen e institucionit. | | |
| Kreu I, Neni 6, Pika 11 | Shërbimi arsimor mbështetet dhe vlerësohet mbi bazën e | | |

| | | | |
|-------------------------------|---|--|--|
| | standardeve. Vlerësimi është i brendshëm dhe i jashtëm. | | |
| Kreu I, Neni 7, Pika 1 | Arsimi parauniversitar është laik. | | |
| Kreu I, Neni 7, Pika 2 | Institucioni arsimor zhvillon lëndë fetare, kur është themeluar nga bashkësi fetare të njohura me ligj, sipas përcaktimeve të nenit 42, pika 4, e këtij ligji. | | |
| Kreu I, Neni 8 | Arsimi parauniversitar është i depolitizuar. | | |
| Kreu I, Neni 9 | Në institucionet arsimore, gjuha e arsimimit është gjuha shqipe, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj. | | |
| Kreu I, Neni 10, Pika 1 | Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, u janë krijuar mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre, sipas planeve dhe programeve mësimore. | | |
| Kreu I, Neni 10, Pika 2 | Për të mundësuar pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë, nxënësve të pakicave kombëtare u janë krijuar kushte për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e historisë e të kulturës shqiptare. | | |
| Kreu I, Neni 10, Pika 3 | Planet e programet mësimore, si dhe raportet e përdorimit të gjuhës amtare dhe asaj zyrtare në procesin mësimor, zhvillohen në përputhje me aktet e veçanta të ministrit. | | |
| Kreu I, Neni 12 | Arsimimi në dy gjuhë në arsimin e mesëm të lartë realizohet sipas marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera. | | |
| Kreu II, Neni 15 | Qendra kulturore e fëmijëve është hapur dhe funksionon bazuar në VKM-në përkatëse. | | |
| Kreu II, Neni 16, Gërma a/b/c | Format e arsimimit në shkollë janë: a) arsimim me kohë të plotë; b) arsimim me kohë të pjesshme; c) arsimim në distancë. | | |
| Kreu II, Neni 17 | Arsimimi në kushtet e shtëpisë ofrohet në raste të veçanta, të përcaktuara nga ministri, për të gjitha klasat e arsimit bazë ose vetëm për disa prej tyre. | | |
| Kreu II, Neni 18 | Individi i moshës shkollore në institucionet e paraburgimit, apo në institucione të përkujdesjes shoqërore merr shërbim arsimor brenda këtyre institucioneve. | | |
| Kreu II, Neni 19 | Kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti, sipas formave dhe kritereve të përkujdesjes të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. | | |
| Kreu II, Neni 20, Pika 1 | Njësia arsimore vendore siguron shërbim psiko-social për nxënësit dhe punonjësit e institucioneve arsimore. | | |
| Kreu II, Neni 20, Pika 2 | Shërbimi psiko-social ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e | | |

| | | | |
|--|---|--|--|
| | rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor. | | |
| Kreu III, Neni 21, Pika 1 | Arsimi parashkollor synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor. | | |
| Kreu III, Neni 21, Pika 2 | Arsimi parashkollor ndiqet nga fëmijët e moshës nga tre deri në gjashtë vjeç. Fëmijëve të moshës pesë vjeç u është mundësuar ndjekja e klasës përgatitore edhe pranë shkollave të arsimit bazë, me synim integrimin në arsimin e detyruar. | | |
| Kreu III, Neni 22, Pika 1 | Arsimi bazë synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës. | | |
| Kreu III, Neni 22, Pika 2 (e # me 56/4) | Institucioni arsimor e ofron arsimin fillor të organizuar në pesë klasa, nga klasa e parë deri në klasën e pestë, ndërsa arsimin e mesëm të ulët të organizuar në katër klasa, nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë. | | |
| Kreu III, Neni 22, Pika 3 | Shkollat e arsimit të orientuar kanë filluar në klasa të caktuara të arsimit bazë, pasi kanë siguruar formimin e mjaftueshëm të nxënësve në lëndët e kulturës së përgjithshme. | | |
| Kreu III, Neni 22, Pika 4 | Arsimi bazë me kohë të plotë është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët që janë shtetas shqiptarë me banim në Republikën e Shqipërisë nga mosha gjashtë vjeç deri në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj. Nxënësit i është dhënë e drejta ta ndjekë arsimin bazë me kohë të plotë deri në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç. Nxënësi, që ka mbushur moshën shtatëmbëdhjetë vjeç dhe nuk ka përfunduar arsimin bazë, është lejuar të përfundojë klasën që po ndjek. Nxënësit, që ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk e ka përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë, i është dhënë e drejta të regjistrohet në shkollat e arsimit bazë me kohë të pjesshme. | | |
| Kreu III, Neni 22, Pika 5 | Nxënësi, që nuk ka ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë me kohë të plotë, i është dhënë e drejta ta ndjekë arsimin bazë me program mësimor individual, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit. | | |
| Kreu III, Neni 23, Pika 1 | Arsimi i mesëm i lartë synon zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi dhe tërësinë e vlerave e të | | |

| | | | |
|---------------------------|--|--|--|
| | <p>qëndrimeve, zgjerimin dhe thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës.</p> <p>Çdo nxënësi që ka përfunduar arsimin bazë i është dhënë mundësia të regjistrohet në arsimin e mesëm të lartë, në përputhje me politikat e Këshillit të Ministrave.</p> | | |
| Kreu III, Neni 23, Pika 2 | <p>Në klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë me kohë të plotë janë pranuar nxënës të moshës jo më të madhe se tetëmbëdhjetë vjeç. Nxënësi deri në moshën njëzet e një vjeç është lejuar të ndjekë arsimin e mesëm të lartë trevjeçar, kurse deri në moshën njëzet e dy vjeç arsimin e mesëm të lartë katërvjeçar.</p> <p>Nxënësi, që ka mbushur përkatësisht moshën njëzet e një vjeç në arsimin e mesëm të lartë trevjeçar apo njëzet e dy vjeç në atë katërvjeçar dhe nuk ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë, është lejuar të vazhdojë klasën që ndjek deri në fund të atij viti shkollor.</p> | | |
| Kreu III, Neni 24, Pika 1 | Llojet e arsimit të mesëm të lartë janë gjimnazi, arsimi i mesëm profesional dhe arsimi i mesëm i orientuar. | | |
| Kreu III, Neni 24, Pika 2 | <p>Gjimnazi përbëhet nga tri klasa.</p> <p>Nxënësve, që kanë mbushur moshën njëzet e një vjeç dhe nuk e kanë përfunduar gjimnazin, u është mundësuar ndjekja e gjimnazit me kohë të pjesëshme ose në distancë.</p> | | |
| Kreu III, Neni 24, Pika 3 | Arsimi i mesëm profesional është me kohëzgjatje dy deri katërvjeçare dhe është i strukturuar në tri nivele kualifikimi, në përputhje me nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. | | |
| Kreu III, Neni 24, Pika 4 | Pranimi në shkollën e arsimit të orientuar (artistike, sportive, gjuhët e huaja dhe fusha të tjera të të nxënët) është bërë sipas kriterëve dhe procedurave që përcaktohen me udhëzim të ministrit. | | |
| Kreu IV, Neni 32, Pika 1 | Institucioni arsimor ka krijuar një mjedis miqësor për nxënësit dhe mundësi që secili nxënës të shfaqë, të zhvillojë individualitetin dhe të realizojë potencialin e tij, në përputhje me këtë ligj. | | |
| Kreu IV, Neni 32, Pika 2 | Institucioni arsimor funksionon sipas rregullores së tij të brendshme, e cila është në përputhje me këtë ligj e aktet e tjera ligjore në fuqi, si dhe është miratuar nga titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse. | | |
| Kreu IV, Neni 32, Pika 3 | Institucioni arsimor u ofron nxënësve mjediset dhe pajisjet për veprimtari sportive, kulturore e zbatimëse edhe pas orëve mësimore, si dhe në ditët e pushimit. | | |
| Kreu IV, Neni 32, Pika 4 | Institucioni arsimor parauniversitar nuk lejon organizimin e veprimtarive partiake në mjediset e tij. | | |
| Kreu IV, Neni 33 | Në institucionin arsimor funksionon komisioni i etikës dhe sjelljes, i përbërë nga mësues, prindër dhe nxënës. | | |

| | | | |
|--|---|--|--|
| | Komisioni ka shqyrtuar ankesat e nxënësve, të prindërve e të punonjësve të institucionit ndaj shkeljeve të normave të etikës dhe të sjelljes dhe i ka propozuar drejtorit të institucionit masat përkatëse. | | |
| Kreu IV, Neni 34, Pika 1 | Institucioni arsimor ka ngritur bordin e tij të përbërë nga prindër, nxënës, mësues, përfaqësues të qeverisë vendore dhe të komunitetit, i cili kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor dhe i raporton për veprimtarinë e tij këshillit të prindërve të institucionit. | | |
| Kreu IV, Neni 34, Pika 2, Gërma a | Bordi ka miratuar planin afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit. | | |
| Kreu IV, Neni 34, Pika 2, Gërma b | Bordi ka miratuar planin e shpenzimeve të institucionit arsimor për fondet, të cilat janë siguruar nga institucioni. | | |
| Kreu IV, Neni 34, Pika 2, Gërma c | Bordi ka miratuar kurrikulën e hartuar nga institucioni arsimor. | | |
| Kreu IV, Neni 34, Pika 2, Gërma ç | Bordi ka marrë pjesë në procedurat e emërimit e të largimit të drejtorit të institucionit arsimor dhe të mësuesit. | | |
| Kreu IV, Neni 34, Pika 3 | Bordi është ngritur dhe ushtron të drejtat e detyrat në përputhje me udhëzimin e ministrit. | | |
| Kreu IV, Neni 35, Pika 1 | Këshilli i mësuesve të institucionit arsimor përbëhet nga mësuesit e shkollës dhe kryesohet nga drejtori. | | |
| Kreu IV, Neni 35, Pika 2 | Këshilli i mësuesve ushtron detyrat dhe funksionet në përputhje me udhëzimin e ministrit. | | |
| Kreu IV, Neni 36, Pika 1 | Qeveria e nxënësve është ngritur dhe funksionon sipas udhëzimit të ministrit. | | |
| Kreu IV, Neni 36, Pika 2 | Kryetari i qeverisë së nxënësve në arsimin e mesëm të lartë është zgjedhur nga nxënësit, me votë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë. | | |
| Kreu IV, Neni 36, Pika 3 | Qeveria e nxënësve ka përzgjedhur mësuesin ndihmës. | | |
| Kreu IV, Neni 36, Pika 4 | Në shkollë funksionojnë edhe organizime të tjera të nxënësve, të ngritura për interesat e tyre shkencore, kulturore dhe sportive. | | |
| Kreu IV, Neni 38, Pika 1 | Institucioni arsimor publik ka përdorur fondin e përfituar nga njësia bazë e qeverisjes vendore përkatëse, sipas formulës “për nxënës”, për shpenzime të vogla, për ndërhyrje emergjente, sipas kriterëve dhe procedurave të vendosura nga Këshilli i Ministrave. | | |
| Kreu IV, Neni 38, Pika 3 (e # me 48/9) | Institucioni arsimor publik ka hapur llogari buxhetore me miratimin e ministrisë dhe ministrisë përgjegjëse për financat. Institucioni arsimor publik i miratuar, mban llogari buxhetore në degën e thesarit të institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar apo llogari në bankat e nivelit të dytë, për të ardhurat e krijuara nga vetë institucioni. | | |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | Institucioni arsimor ka ndjekur rregullat e administrimit financiar, në përputhje me udhëzimin e ministrit për arsimin dhe ministrit për financat. | | |
| Kreu IV, Neni 39, Pika 2 | Shkollat private e kanë përdorur mbështetjen financiare nga Ministria e Arsimit vetëm për nxënësit e shkëlqyer në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare. | | |
| Kreu V, Neni 40, Pika 1 | Institucioni arsimor publik, në pajtueshmëri me politikat e tij, ka përfiturar fonde financiare ose mbështetje materiale nga dhurues ose sponsorizues, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga ministri për arsimin, në bashkëpunim me ministrin e financave. Dhurimet dhe sponsorizimet janë vënë në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit arsimor. | | |
| Kreu V, Neni 40, Pika 2 | Institucioni arsimor publik ka siguruar të ardhura dhe shërbime për të tretët, në përputhje me fushën e veprimtarisë së tij dhe i përdor ato sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. | | |
| Kreu VI, Neni 42, Pika 1 | Institucioni arsimor privat është krijuar dhe funksionon sipas këtij ligji, përveç rasteve kur ligji ka formulim të veçantë për institucionet arsimore publike, si edhe akteve nënligjore të nxjerra në mënyrë specifike për to. | | |
| Kreu VI, Neni 42, Pika 2 | Licencimi i institucionit privat është bërë nëpërmjet institucionit përkatës të licencimit, sipas vendimit të ministrit. Licencimi i institucionit privat është bërë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Institucioni arsimor privat e ka filluar veprimtarinë e tij vetëm pas marrjes së licencës. | | |
| Kreu VI, Neni 42, Pika 3 (e # me 48/10) | Pezullimi dhe revokimi i licencave të institucioneve arsimore private, që përmenden në pikën 2 të këtij neni, janë kryer nga institucioni përgjegjës për licencimin, me vendim të ministrit. Në rast se institucioni arsimor privat ka ndërprerë veprimtarinë me iniciativën e vet, atëherë ai ka paraqitur kërkesë në institucionin përgjegjës për licencimin për revokim vullnetar të licencës. | | |
| Kreu VI, Neni 42, Pika 4 | Institucioni arsimor privat, që zhvillon edhe lëndë fetare, ose është themeluar apo administruar nga bashkësia fetare, është hapur dhe mbyllur me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, mbështetur në kërkesën e përfaqësuesve të bashkësive fetare. | | |
| Kreu VI, Neni 42, Pika 5 | Shkolla private, në të cilën mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, ose që lëshon diplomë të huaj apo të ngjashme me të, është hapur/ mbyllur me vendim të | | |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit. | | |
| Kreu VI, Neni 42, Pika 6 | Shkolla private, e cila zhvillohen lëndë fetare, ose arsimim në gjuhë të huaj, zhvillon detyrimisht në gjuhën shqipe lëndët: gjuhë shqipe dhe letërsi, histori e kombit shqiptar dhe gjeografi e Shqipërisë. | | |
| Kreu VI, Neni 42, Pika 7 (e # me 48/10) | Institucioni arsimor privat e ka ndërprerë veprimtarinë me iniciativën e vet vetëm në fund të vitit shkollor. Institucionit arsimor me shkelje të kriterëve të licencimit i është revokuar licenca dhe është publikuar vendimi për revokimin e licencës në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve. | | |
| Kreu VI, Neni 43, Pika 1 | Institucioni arsimor privat e përdor licencën vetëm për subjektin përgjegjës dhe vetëm për atë nivel arsimor, vendndodhje dhe mjedise, për të cilat i është dhënë fillimisht. | | |
| Kreu VI, Neni 43, Pika 2 | Çdo ndryshim i bërë nga ana e subjektit të licencuar është miratuar nga ministri dhe institucioni përgjegjës për licencimin. Në rast se ndryshimet e bëra kanë të bëjnë me kriteret e licencimit, licenca është revokuar dhe është bërë aplikim i ri. | | |
| Kreu VII, Neni 44, Pika 1 | Kurrikula zhvillohet si një e tërë për të gjitha nivelet arsimore, për sa i përket formimit të vlerave, aftësive e koncepteve kryesore, si dhe parimeve të mësimdhënies, të të nxënësve dhe të vlerësimit të nxënësve. | | |
| Kreu VII, Neni 44, Pika 2 | Kurrikula është në përputhje me ecurinë e zhvillimit fizik, mendor, shoqëror, etik të nxënësve dhe veçoritë e tyre individuale të të nxënësve. | | |
| Kreu VII, Neni 44, Pika 3 | Kurrikula hartohet dhe zbatohet në bazë të kompetencave themelore të nxënësve. | | |
| Kreu VII, Neni 44, Pika 4 | Kurrikula, sipas niveleve arsimore dhe klasave, hartohet dhe zhvillohet në bazë të kornizës kurrikulare të arsimit parauniversitar. | | |
| Kreu VII, Neni 44, Pika 5 | Kurrikula mishëron parimin e integritetit nëpërmjet fushave të të nxënësve dhe lëndore. | | |
| Kreu VII, Neni 44, Pika 6 | Kurrikula u mundëson nxënësve zgjedhje individuale, sipas nevojave dhe interesave të tyre. | | |
| Kreu VII, Neni 45, Pika 1 | Institucioni arsimor e strukturon kurrikulën në: kurrikul bërthamë, kurrikul me zgjedhje, si dhe kurrikul për veprimtaritë plotësuese. | | |
| Kreu VII, Neni 45, Pika 3 | Drejtori i institucionit arsimor ka miratuar kurrikulën e hartuar në nivel institucioni, pas marrjes së pëlqimit nga njësisia arsimore vendore. | | |
| Kreu VII, Neni 46 | Institucioni arsimor privat zbaton planin dhe programin mësimor të miratuar në momentin e licencimit. Për çdo ndryshim institucioni arsimor privat ka marrë | | |

| | | | |
|---|--|--|--|
| | miratimin e ministrit. | | |
| Kreu VII, Neni 47, Pika 1 (e # me 56/6) | <p>Tekstet shkollore janë përzgjedhur nga mësuesit në bazë shkolle, pas certifikimit nga ministria, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit, me përjashtim të rasteve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p>Tekstet për nxënësit janë alternative. Numri i alternativave të teksteve shkollore kufizohet në jo më shumë se tri alternativa për çdo lëndë ose fushë të të nxënit.</p> <p>Tekstet shkollore sigurohen nga botuesit, vendas ose të huaj, mbi bazën e standardeve të teksteve, nëpërmjet një konkurrimi të hapur, të barabartë dhe transparent, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.</p> | | |
| Kreu VII, Neni 47, Pika 4 | Shpërndarja dhe shitja e teksteve shkollore është bërë nëpërmjet njërive tregtare të shitjes së librave ose në pika të tjera shitjeje pranë shkollave nga subjekte të licencuara, me çmime të vendosura nga botuesit e të vlerësuara nga ministria në procesin e certifikimit të tekstit. | | |
| Kreu VIII, Neni 48, Pika 1 | Institucioni arsimor e kryen vlerësimin e nxënësve me qëllim evidentimin e arritjeve të të nxënit. | | |
| Kreu VIII, Neni 48, Pika 2 (e # me 48/11) | <p>Institucioni arsimor ka vlerësuar nxënësit e klasës së parë, të dytë dhe të tretë me fjalë dhe shprehje.</p> <p>Nxënësit e klasave të tjera janë vlerësuar me nota, numra të plotë nga katër deri në dhjetë, ku nota më e ulët kaluese është nota pesë, dhe vlerësimi përfundimtar shoqërohet me përshtkrim.</p> | | |
| Kreu VIII, Neni 48, Pika 3 | Institucioni arsimor ka kaluar në klasën pasardhëse nxënësit e klasave të para, të dyta dhe të treta, me përjashtim të rasteve kur është kërkuar të vazhdojë të njëjtën klasë nga prindërit e tij. | | |
| Kreu VIII, Neni 48, Pika 4 (e # me 48/11) | Llojet e vlerësimit, kalimi ose përsëritja e klasës, njehsimi i notës vjetore lëndore dhe notës mesatare të nxënësit për një vit shkollor janë kryer sipas udhëzimit të ministrit. | | |
| Kreu VIII, Neni 49, Pika 1 (e # me 48/12) | Vlerësimi i jashtëm i nxënësve realizohet nëpërmjet vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor, provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe provimeve të maturës shtetërore, si dhe nëpërmjet një numri të caktuar nxënësish. | | |
| Kreu VIII, Neni 49, Pika 2 | Nxënësit me aftësi të kufizuara kanë zhvilluar provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre. | | |
| Kreu VIII, Neni 49, Pika 3 | <p>Hartimi i testeve, administrimi dhe vlerësimi në provimet kombëtare është kryer nga mësues të certifikuar.</p> <p>Pagesa e tyre është bërë sipas akteve nënligjore në fuqi.</p> | | |

| | | | |
|---|--|--|--|
| Kreu VIII, Neni 50, Pika 1 | Në provimet kombëtare të arsimit bazë, nxënësit janë vlerësuar në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe gjuhë e huaj. | | |
| Kreu VIII, Neni 50, Pika 2 | Nxënësit e pakicave kombëtare janë vlerësuar në lëndët gjuhë amtare, gjuhë shqipe, matematikë dhe, sipas dëshirës, edhe në një gjuhë të huaj. | | |
| Kreu VIII, Neni 50, Pika 3 (e # me 48/13) | Institucioni arsimor ka organizuar dhe zhvilluar vlerësimin e arritjeve të nxënësve në arsimin fillor dhe në provimet kombëtare të arsimit bazë në përputhje me udhëzimin e ministrit. | | |
| Kreu VIII, Neni 51 | Në provimet e maturës shtetërore nxënësit ka dhënë një numër lëndësh të përbashkëta dhe një numër lëndësh me zgjedhje. Të gjithë nxënësit kanë dhënë këto tre lëndë të përbashkëta: gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë dhe një gjuhë e huaj. Lëndët me zgjedhje janë dhënë sipas udhëzimit të ministrit. Organizimi dhe zhvillimi i provimeve kombëtare të maturës shtetërore është kryer në përputhje me udhëzim të ministrit. | | |
| Kreu VIII, Neni 52, Pika 1 | Institucioni arsimor ka pajisur nxënësin me dëftesën e arsimit bazë, e cila është lëshuar nga drejtori i shkollës, pasi nxënësi ka qenë kalues në provimet kombëtare të arsimit bazë. Institucioni arsimor ka pajisur nxënësin me dokumentin e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë (diplomë e maturës shtetërore), e cila është lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, pasi nxënësi ka qenë kalues në provimet kombëtare, të detyruara dhe me zgjedhje të maturës shtetërore. | | |
| Kreu VIII, Neni 52, Pika 2 | Institucioni arsimor, në përfundim të çdo klase, ka pajisur nxënësin me dëftesë, e cila është lëshuar sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. | | |
| Kreu VIII, Neni 52, Pika 3 | Shkolla private e arsimit të mesëm të lartë e licencuar ka lëshuar diplomë të një institucioni arsimor të huaj ose të ngjashëm me të, sipas procedurave për njësimin e këtyre diplomave të përcaktuara nga ministri. | | |
| Kreu VIII, Neni 52, Pika 4 | Kriteret dhe procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit, janë kryer në përputhje me udhëzimin e ministrit. | | |
| Kreu VIII, Neni 53, Pika 1 (e # me 56/7) | Nxënësve të shkëlqyer në vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, u është dhënë “Medalje e artë” nga Kryeministri, me propozimin e ministrit. | | |
| Kreu VIII, Neni 53, Pika 2 | “Medalja e artë” është dhënë sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit. | | |
| Kreu IX, Neni 54, Pika 1 | Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor. | | |
| Kreu IX, Neni 54, Pika 2, Gërma a | Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, zbaton këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. | | |

| | | | |
|---|--|--|--|
| Kreu IX, Neni 54, Pika 2, Gërma b | Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, përmirëson cilësinë e shërbimit arsimor. | | |
| Kreu IX, Neni 54, Pika 2, Gërma c | Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat zbaton dhe zhvillon kurrikulën. | | |
| Kreu IX, Neni 54, Pika 2, Gërma ç | Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat menaxhon personelin dhe krijon kushte për zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit. | | |
| Kreu IX, Neni 54, Pika 3, Gërma a | Drejtori i institucionit arsimor publik menaxhon institucionin, përfshirë edhe menaxhimin financiar. | | |
| Kreu IX, Neni 54, Pika 3, Gërma b | Drejtori i institucionit arsimor publik ka përdorur një fond të veçantë vjetor nga buxheti i njësisë arsimore vendore, për shpërblimin për merita profesionale të mësuesve, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, pas këshillimit me partnerët socialë dhe bordin e institucionit. | | |
| Kreu IX, Neni 54, Pika 3, Gërma c | Drejtori i institucionit arsimor publik ka punësuar mësues me kohë të plotë ose të pjesshme dhe mësues ndihmës, me fonde të siguruar nga institucioni, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit të arsimit dhe ministrit të financave. Pagesa është dhënë sipas masës së përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi. | | |
| Kreu IX, Neni 54, Pika 4 | Drejtori i institucionit arsimor ka lejuar të përdoren nga nxënësit vetëm botime ndihmëse dhe materiale të tjera mësimore, të miratuara nga ministri i arsimit, nëpërmjet udhëzimeve të tij. | | |
| Kreu IX, Neni 55, Pika 1 | Drejtori i institucionit arsimor publik është emëruar nga titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse, pas propozimit të dy kandidatëve që janë vlerësuar me konkurrencë të hapur nga komisioni i vlerësimit. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga një përfaqësues i njësisë bazë të qeverisjes vendore, kryetari i bordit të institucionit, kryetari i këshillit të prindërve të institucionit dhe dy mësues të institucionit arsimor të zgjedhur nga këshilli i mësuesve. Njëri prej dy mësuesve, me përvojën më të gjatë në atë institucion arsimor, ka drejtuar komisionin e vlerësimit. Procedurat për emërimin dhe/ose shkarkimin e drejtorit të institucionit janë kryer sipas udhëzimit të ministrit. | | |
| Kreu IX, Neni 55, Pika 2 (e # me 48/14) | Kandidati për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor ka të paktën, kategorinë “Mësues i kualifikuar” dhe është i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar. Certifikimi i kandidatit për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor është kryer pas zhvillimit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për | | |

| | | | |
|---|---|--|--|
| | drejtimin e institucionit arsimor. Drejtori i institucionit arsimor nuk është anëtar i forumeve drejtuese të partive politike. | | |
| Kreu IX, Neni 55, Pika 3 | Titullari i njësisë arsimore ka shkarkuar drejtorin e institucionit arsimor publik për shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të tij, shkelje të etikës e të sjelljes në institucion, si dhe për mosrealizime të institucionit. | | |
| Kreu IX, Neni 55, Pika 4 | Emërimi dhe/ose shkarkimi i drejtorit të institucionit arsimor privat është kryer sipas procedurave të përcaktuara nga vetë institucioni në rregulloren e tij. Kriteret e kualifikimit për drejtorin e institucionit arsimor privat janë të njëjta, me kriteret e përcaktuara për drejtorin e institucionit arsimor publik. | | |
| Kreu IX, Neni 55, Pika 5 | Drejtori i institucionit ka emëruar apo shkarkuar nëndrejtorin pas marrjes së pëlqimit të këshillit të mësuesve. | | |
| Kreu IX, Neni 55/1, Pika 1 (e shtuar me 48/15/1) | Drejtori i institucionit arsimor parashkollor është emëruar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, pas propozimit të dy kandidatëve që janë vlerësuar me konkurrim të hapur nga komisioni i vlerësimit. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore, kryetari i bordit të institucionit, kryetari i këshillit të prindërve të institucionit, një përfaqësues nga njësia arsimore vendore dhe një mësues i zgjedhur nga këshilli i mësuesve. | | |
| Kreu IX, Neni 55/1, Pika 2 (e shtuar me 48/15/2) | Kandidati për drejtor i institucionit arsimor parashkollor ka të paktën pesë vjet përvojë pune si mësues, është trajnuar dhe pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar dhe nuk bën pjesë, pas emërimit, në forumet drejtuese të partive politike. | | |
| Kreu IX, Neni 55/1, Pika 3 (e shtuar me 48/15/3) | Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ka shkarkuar drejtorin e institucionit arsimor parashkollor publik për shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore të tij, si dhe për shkelje të sjelljes në institucion. | | |
| Kreu IX, Neni 55/1, Pika 4 (e shtuar me 48/15/4) | Emërimi dhe/ose shkarkimi i drejtorit të institucionit arsimor parashkollor privat është kryer sipas procedurave të përcaktuara nga vetë institucioni në rregulloren e tij. Kriteret e kualifikimit për drejtorin e institucionit arsimor parashkollor privat, janë të njëjta me kriteret e përcaktuara për drejtorin e institucionit arsimor parashkollor publik. | | |
| Kreu IX, Neni 56, Pika 1 | Mësuesi zhvillon mësimdhënien me synim zotërimin e kompetencave themelore, në bazë të standardeve të të nxënit dhe duke përzgjedhur ndërmjet metodave dhe | | |

| | | | |
|---|--|--|--|
| | praktikave bashkëkohore më të mira, vendase e të huaja. | | |
| Kreu IX, Neni 56, Pika 2, Gërma a | Institucioni arsimor i ka dhënë mësuesit liri profesionale në zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës, në përputhje me këtë ligj. | | |
| Kreu IX, Neni 56, Pika 2, Gërma b | Institucioni arsimor i ka siguruar mësuesit kushtet e mjaftueshme për mësimdhënie efektive. | | |
| Kreu IX, Neni 56, Pika 2, Gërma c | Institucioni arsimor i ka siguruar mësuesit mundësi për zhvillim profesional. | | |
| Kreu IX, Neni 56, Pika 2, Gërma ç | Institucioni arsimor i ka mundësuar mësuesit të zgjidhet dhe të zgjedhë anëtarë në bordin e institucionit dhe në komisionin e etikës dhe sjelljes. | | |
| Kreu IX, Neni 56, Pika 3, Gërma a | Mësuesi zbaton këtë ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij. | | |
| Kreu IX, Neni 56, Pika 3, Gërma b | Mësuesi përkujdeset për mbarëvajtjen e çdo nxënësi të tij. | | |
| Kreu IX, Neni 56, Pika 3, Gërma c | Mësuesi zbaton dhe zhvillon kurrikulën. | | |
| Kreu IX, Neni 56, Pika 3, Gërma ç | Mësuesi përditëson kompetencat profesionale. | | |
| Kreu IX, Neni 56, Pika 3, Gërma d | Mësuesi zbaton rregulloren e institucionit. | | |
| Kreu IX, Neni 56, Pika 3, Gërma dh | Mësuesi jep ndihmesën e tij për mbarëvajtjen e institucionit ku punon. | | |
| Kreu IX, Neni 57, Pika 1 (i # me 48/16) | Mësuesi për arsimin parashkollor ka fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor. | | |
| Kreu IX, Neni 57, Pika 2 (i # me 48/16) | Mësuesi për arsimin fillor ka fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor” dhe diplomë të ciklit të dytë “Master Profesional” që formon mësues të arsimit fillor, ose diplomë për arsimin fillor të ish-instituteve të larta pedagogjike. | | |
| Kreu IX, Neni 57, Pika 3 (i # me 48/16) | Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët dhe për arsimin e mesëm të lartë ka fituar diplomë të ciklit të parë “Bachelor” në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë dhe diplomë të ciklit të dytë “Master” me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë. | | |
| Kreu IX, Neni 57, Pika 4 (i # me 48/16) | Profesionin e mësuesit e ushtrojnë edhe individë që zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë ose diplomë universitare të integruar, të ngjashme ose të përafërt me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar, dhe njohuri të certifikuara në formimin psikopedagogjik nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar të përcaktuara me udhëzim të ministrit. | | |
| Kreu IX, Neni 57, Pika 5/a | Mësuesi i arsimit fillor, i arsimit të mesëm të ulët dhe i | | |

| | | | |
|--|---|--|--|
| (i # me 48/16) | arsimit të mesëm të lartë, mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi me diplomë të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar, ushtron profesionin pasi ka kryer me sukses praktikën profesionale. | | |
| Kreu IX, Neni 57, Pika 5/b (i # me 48/16) | Mësuesi i arsimit fillor, i arsimit të mesëm të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë, mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi me diplomë të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar, ushtron profesionin pasi ka kaluar me sukses provimin e shtetit në fushën e formimit të tij, siç parashikohet në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij”. | | |
| Kreu IX, Neni 58, Pika 1 | Institucioni arsimor ka planifikuar zhvillimin profesional të mësuesve, sipas nevojave të tyre dhe në përputhje me politikat arsimore qendrore, vendore dhe të institucionit. | | |
| Kreu IX, Neni 58, Pika 2 | Mësuesi ka kryer zhvillimin profesional në forma të tilla si: zhvillimi i brendshëm profesional, trajnimet, rrjetet profesionale, këshillimet, kurset afatshkurtra dhe ato afatgjata. | | |
| Kreu IX, Neni 58, Pika 3 | Mësuesit dhe drejtori janë trajnuar të paktën 3 ditë në vit. | | |
| Kreu IX, Neni 58, Pika 4 | Trajnimet janë zhvilluar sipas sistemit “kërkesë - ofertë”, në bazë të kërkesave nga institucionet arsimore dhe të ofertave nga agjenci trajnuese që mund të jenë publike ose private. Programet trajnuese janë të akredituara nga ministria. | | |
| Kreu IX, Neni 58, Pika 5 | Njësia arsimore vendore ka organizuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve, në bashkëpunim me agjenci trajnuese, me programe trajnimi të akredituara, të përzgjedhura me konkurrim të hapur, sipas procedurave të parashikuara në udhëzimin e ministrit. | | |
| Kreu IX, Neni 58, Pika 6 | Punonjësit arsimorë i kryejnë trajnimet me burimet financiare nga kontributi vetjak, Buxheti i Shtetit, projekte të organizatave jofitimprurëse, të fondacioneve, të institucioneve, vendase ose të huaja dhe burime të tjera të ligjshme. | | |
| Kreu IX, Neni 59, Pika 1 | Mësuesit janë kualifikuar në tri kategori, përkatësisht : a) "Mësues i kualifikuar"; b) "Mësues specialist"; c) "Mësues mjeshër". | | |

| | | | |
|---|---|--|--|
| Kreu IX, Neni 59, Pika 2 | Rritja në kategori e mësuesit është bërë nëpërmjet përvojës, trajnimit dhe pasi ka dhënë me sukses provimin përfundimtar të kategorisë përkatëse të kualifikimit, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit. | | |
| Kreu IX, Neni 59, Pika 3 | Mësuesi që ka fituar kategorinë e kualifikimit, ka përfituar një shtesë në pagë, në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. | | |
| Kreu IX, Neni 60, Pika 1 (i # me 48/17) | Institucioni arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, ka pranuar dhe emëruar mësuesin në një vend të lirë pune, mbështetur në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit është bërë nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “Mësues për Shqipërinë”. | | |
| Kreu IX, Neni 60, Pika 2, Gërma a | Drejtori i institucionit publik ka larguar mësuesin nga institucioni për shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore. | | |
| Kreu IX, Neni 60, Pika 2, Gërma b | Drejtori i institucionit publik ka larguar mësuesin nga institucioni për shkelje të etikës e të sjelljes në institucion. | | |
| Kreu IX, Neni 60, Pika 2, Gërma c | Drejtori i institucionit publik ka larguar mësuesin nga institucioni për mosarritje të nxënësve, të përcaktuara në mënyrë objektive, si testimet e drejtorisë së institucionit ose të njësisë arsimore vendore, rezultatet në provimet kombëtare dhe vlerësimin të institucionit përgjegjës për sigurimin e cilësisë. | | |
| Kreu IX, Neni 60, Pika 3 (i # me 56/8) | Drejtori i institucionit arsimor publik ka filluar procedurën e largimit të mësuesit edhe me kërkesë të prindërve dhe ka vendosur largimin e mësuesit, pasi është konsultuar me përfaqësues të prindërve të institucionit arsimor, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit. | | |
| Kreu X, Neni 61, Pika 1, Gërma a | Nxënësit i është dhënë e drejta të përzgjedhë një institucion arsimor publik ose privat. | | |
| Kreu X, Neni 61, Pika 1, Gërma b | Nxënësit i është dhënë e drejta të ndjekë institucionin arsimor publik që është në zonën e përcaktuar nga njësia bazë përkatëse e vetëqeverisjes vendore. | | |
| Kreu X, Neni 61, Pika 1, Gërma c | Institucioni arsimor i siguron nxënësit shërbim arsimor cilësor, sipas interesave, nevojave dhe mundësive të tij, si dhe ndihmë të posaçme për të përballuar vështirësitë e tij të veçanta të të nxënësve. | | |
| Kreu X, Neni 61, Pika 1, Gërma ç | Institucioni arsimor ka informuar nxënësin me të drejtat e detyrimet e tij, rregulloren e institucionit arsimor, për kurrikulën që institucioni i ofron, për format e vlerësimit, për provimet kombëtare, si dhe e ka vënë në dijeni me | | |

| | | | |
|-----------------------------------|--|--|--|
| | shkrim për rezultatet e ndërmjetme dhe përfundimtare të arsimimit të tij. | | |
| Kreu X, Neni 61, Pika 1, Gërma d | Institucioni arsimor i ka mundësuar nxënësit të shprehë pikëpamjet për çështje të arsimimit të tij, të ankohet për qëndrimet ndaj tij dhe të ketë vëmendjen e punonjësve të institucionit arsimor për këto pikëpamje e ankesa. | | |
| Kreu X, Neni 61, Pika 1, Gërma dh | Institucioni arsimor i ka mundësuar nxënësit të zgjidhet në bordin e shkollës, pas moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç. | | |
| Kreu X, Neni 61, Pika 1, Gërma e | Institucioni arsimor i ka mundësuar nxënësit të transferohet nga një shkollë në një shkollë tjetër të të njëjtit nivel arsimor. | | |
| Kreu X, Neni 61, Pika 2, Gërma a | Nxënësi respekton të drejtat e nxënësve të tjerë dhe të punonjësve të institucionit, të njohura me ligj. | | |
| Kreu X, Neni 61, Pika 2, Gërma b | Nxënësi mëson rregullisht. | | |
| Kreu X, Neni 61, Pika 2, Gërma c | Nxënësi vijon rregullisht procesin mësimor dhe merr pjesë në veprimtari të tjera të institucionit. | | |
| Kreu X, Neni 61, Pika 2, Gërma ç | Nxënësi respekton rregullat e institucionit për mbrojtjen e shëndetit, të sigurisë e të mjedisit dhe kërkon respektimin e tyre nga nxënësit e tjerë dhe punonjësit arsimorë. | | |
| Kreu X, Neni 61, Pika 2, Gërma d | Nxënësi respekton rregulloren e institucionit. | | |
| Kreu X, Neni 62, Pika 1 | Prindërit ndihmojnë në mbarëvajtjen e fëmijës dhe të institucionit. | | |
| Kreu X, Neni 62, Pika 2, Gërma a | Institucioni arsimor ka informuar prindin për legjislacionin arsimor në fuqi, për rregulloren e institucionit dhe për kurrikulën që institucioni i ofron fëmijës së tij. | | |
| Kreu X, Neni 62, Pika 2, Gërma b | Institucioni arsimor ka informuar prindin për kushtet e sigurisë, të shëndetit dhe të mjedisit të institucionit dhe kërkon përmbushjen e tyre, sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar. | | |
| Kreu X, Neni 62, Pika 2, Gërma c | Institucioni arsimor ka informuar prindin për veprimtarinë e fëmijës së tij në institucion dhe i ka kërkuar të japë pëlqim për veprimtaritë plotësuese dhe jashtëshkollore që organizon shkolla. | | |
| Kreu X, Neni 62, Pika 2, Gërma ç | Institucioni arsimor ka vënë në dijeni prindin për drejtimit kryesore të veprimtarisë së institucionit dhe arritjet e institucionit në krahasim me institucione të ngjashme. | | |
| Kreu X, Neni 62, Pika 3, Gërma a | Prindi kujdeset që fëmija i tij të ndjekë rregullisht institucionin arsimor dhe të mësojë rregullisht. | | |
| Kreu X, Neni 62, Pika 3, Gërma b | Prindi njofton institucionin arsimor për ndryshime të shëndetit dhe të sjelljes së fëmijës së tij. | | |
| Kreu X, Neni 62, Pika 3, | Prindi merr pjesë në takimet për çështje që kanë të bëjnë | | |

| | | | |
|---|--|--|--|
| Gërma c | me fëmijën e tij. | | |
| Kreu X, Neni 62, Pika 3, Gërma ç | Prindi kontribuon në mbarëvajtjen e institucionit. | | |
| Kreu XI, Neni 63, Pika 1 (i # me 48/18) | Institucioni arsimor ka mundësuar që fëmijët me aftësi të kufizuara të arrijnë zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës së tyre, për t'i përgatitur për gjithëpërfshirje në shoqëri dhe në tregun e punës. | | |
| Kreu XI, Neni 63, Pika 2 (i # me 48/18) | Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet e arsimit të special për ta ka qenë përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë ka qenë parësore. | | |
| Kreu XI, Neni 63, Pika 3 (i # me 48/18) | Nxënësve me aftësi të kufizuara në dëgjim, shikim dhe komunikim u është garantuar e drejta e edukimit në gjuhën e shenjave, e drejta e përdorimit të shkrimit Brail, si dhe e mjeteve didaktike në formë elektronike të specializuara, në funksion të edukimit të tyre. | | |
| Kreu XI, Neni 64, Pika 1 | Nxënësve me aftësi të kufizuara u është siguruar arsimimi në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, sipas kritereve të miratuara nga ministri i arsimit dhe ministri i shëndetësisë. | | |
| Kreu XI, Neni 64, Pika 2 | Nxënësi me aftësi të kufizuara qëndron në shkolla të specializuara deri në moshën 19 vjeç. | | |
| Kreu XI, Neni 64, Pika 3 | Njësia arsimore vendore ka krijuar një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi ka shqyrtuar kërkesën e prindit ose të drejtorit të institucionit arsimor, ka dhënë rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm apo të specializuar. | | |
| Kreu XI, Neni 64, Pika 4 | Prindërit kanë vendosur nëse fëmija i tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Prindërit kanë mundur të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur kanë gjykuar se ai nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira. | | |
| Kreu XI, Neni 64, Pika 6 | Njësia arsimore vendore, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit të arsimit dhe të ministrit të shëndetësisë, u ka siguruar arsimim në shtëpi nxënësve që nuk kanë mundur të ndjekin një shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë. | | |
| Kreu XI, Neni 65, Pika 1 | Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të | | |

| | | | |
|---------------------------|---|--|--|
| | përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta. | | |
| Kreu XI, Neni 65, Pika 2 | Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara është hartuar nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënimit të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi është bërë në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor është vendosur nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës. | | |
| Kreu XI, Neni 65, Pika 3 | Nxënësve me aftësi të kufizuara u është siguruar mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kritereve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, janë certifikuar në programe trajnimi për trajtimin e këtyre nxënësve. | | |
| Kreu XI, Neni 65, Pika 4 | Njësia përkatëse bazë e qeverisjes vendore u ka siguruar nxënësve me aftësi të kufizuara mjediset e përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënimit, sipas standardeve të përcaktuara nga ministria. | | |
| Kreu XII, Neni 66, Pika 1 | Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave personale të nxënësve dhe të punonjësve të sistemit arsimor, janë bërë në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. | | |
| Kreu XII, Neni 66, Pika 2 | Nxënësit kanë dhënë të dhënat personale, sipas pikës 1, të këtij neni. Institucioni arsimor ka njoftuar paraprakisht personat për këtë detyrim ligjor. | | |
| Kreu XII, Neni 66, Pika 3 | Institucioni arsimor ka mbledhur e përpunuar të dhëna personale të personave, të përcaktuar me udhëzim të ministrit, dhe i ka vendosur ato në dokumentet zyrtare, si dhe në dosjen vetjake të personit. | | |
| Kreu XII, Neni 66, Pika 4 | Pëlqimi për t’i përdorur të dhënat personale është dhënë nga vetë personi, kur ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, përndryshe është dhënë nga prindërit e tij. Pëlqimi është paraqitur me shkrim. | | |
| Kreu XII, Neni 67, Pika 1 | Personit i është dhënë e drejta të njihet me të dhënat e tij personale, që disponon institucioni arsimor përkatës. | | |
| Kreu XII, Neni 67, Pika 2 | Punonjësit e institucionit arsimor nuk kanë vënë në dispozicion të tjerëve, jashtë institucionit, të dhëna personale të një personi, duke treguar identitetin e tij, me përjashtim të rasteve kur personi ka paraqitur kërkesën ose ka dhënë pëlqimin. | | |
| Kreu XII, Neni 67, Pika 3 | Drejtuesi i institucionit arsimor u ka dërguar zyrtarisht | | |

| | | | |
|-------------------------------------|---|--|--|
| | institucioneve, që përcaktohen me udhëzim të ministrit, të dhëna personale pa identifikuar personat. | | |
| Kreu XII, Neni 67, Pika 4 | Rezultatet e nxënësve në provimet kombëtare dhe të dhënat e tyre për hyrjen në institucionet e shkollave të larta, si dhe rezultatet e mësuesve në provimet e kualifikimit nuk zbulojnë identitetin e personit. | | |
| Kreu XII, Neni 67, Pika 5 | Punonjësi i institucionit arsimor nuk ka dhënë të dhëna për arritjet mësimore dhe sjelljen e një nxënësi të institucionit arsimor në mënyrë publike ose t'ia ketë dhënë ato një personi të veçantë. | | |
| Kreu XII, Neni 67, Pika 6 | Të dhënat personale të një grupi personash u janë vënë në dispozicion institucioneve të tjera për studime, vetëm pas miratimit me shkrim të drejtorit të institucionit arsimor, pa zbuluar identitetin e tyre. | | |
| Kreu XIII, Neni 68 | Mosregjistrimi dhe mungesat e paarsyeshme të fëmijës në mësim për më shumë se 25 për qind të orëve mësimore gjatë një viti shkollor janë vlerësuar si rast i neglizhencës prindërore dhe janë trajtuar në përputhje me ligjin nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”. | | |
| Kreu XIII, Neni 69, Pika 1 | Hapja dhe ushtrimi i veprimtarisë së institucioneve arsimore private pa licencën përkatëse, sipas këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative. Kundërvajtësi dënohet me dënim administrativ kryesor gjorbë, në vlerën nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë, dhe me dënim administrativ plotësues “ndërprerjen e menjëhershme të veprimtarisë”. | | |
| Kreu XIII, Neni 69, Pika 2 | Vendimi për dënimin e kundërvajtësit, sipas pikës 1 të këtij neni, është në kompetencën e institucionit përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe merret në vend me konstatimin e shkeljes. | | |
| Kreu XIII, Neni 70, Pika 1, Gërma a | Shkelja e kërkesave ligjore për veprimtarinë e institucioneve arsimore private, përbën kundërvajtje administrative, që konstatohet dhe dënohet nga institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar me dënim administrativ kryesor: a) paralajmërim. | | |
| Kreu XIII, Neni 70, Pika 1, Gërma b | Shkelja e kërkesave ligjore për veprimtarinë e institucioneve arsimore private, përbën kundërvajtje administrative, që konstatohet dhe dënohet nga institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar me dënim administrativ kryesor: b) gjorbë në vlerën nga 10 000 deri në 100 000 lekë. | | |
| Kreu XIII, Neni 70, Pika 2 | Kur është e nevojshme, institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar vendos, që | | |

| | | | |
|-------------------------------------|--|--|--|
| | dënimi administrativ kryesor, sipas pikës 1, të këtij neni, të shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. | | |
| Kreu XIII, Neni 70, Pika 3 | Në rast të konstatimit të shkeljeve të rënda, që përbëjnë mosplotësim të kushteve të licencimit për institucionin arsimor privat, institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar merr vendimin për dënimin e kundërvajtësit, me dënimin kryesor të parashikuar nga shkronja “b”, e pikës 1, të këtij neni dhe, nëse është e nevojshme, propozon dënimin administrativ plotësues të pezullimit apo heqjes së licencës për ushtrimin e veprimtarisë. Vendimi përfundimtar për pezullimin apo heqjen e licencës është në kompetencën e ministrit. | | |
| Kreu XIII, Neni 70, Pika 4 | Institucioni arsimor privat, licenca e të cilit është pezulluar, e ka fituar atë për vitin pasardhës shkollor, pasi ka plotësuar kushtet e licencimit. | | |
| Kreu XIII, Neni 70, Pika 5 | Në rast të pezullimit dhe/ose heqjes së një licence, njësia arsimore vendore përkatëse i ka vendosur nxënësit në institucione të tjera arsimore, publike ose private. Shpenzimet për përfundimin e një viti shkollor, për të gjithë nxënësit e regjistruar në atë shkollë private, janë përballuar nga garancia bankare e institucionit arsimor privat të mbyllur. Modalitetet e transferimit të nxënësve janë kryer sipas udhëzimit të ministrit. | | |
| Kreu XIII, Neni 71, Pika 1, Gërma a | Shkelja e kërkesave ligjore për veprimtarinë e institucioneve arsimore publike përbën kundërvajtje administrative nga drejtori i institucionit arsimor publik, që konstatohet dhe dënohet nga institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar me dënim administrativ kryesor: a) paralajmërim. | | |
| Kreu XIII, Neni 71, Pika 1, Gërma b | Shkelja e kërkesave ligjore për veprimtarinë e institucioneve arsimore publike përbën kundërvajtje administrative nga drejtori i institucionit arsimor publik, që konstatohet dhe dënohet nga institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar me dënim administrativ kryesor: b) gjobë, në vlerën e gjysmës së pagës mujore. | | |
| Kreu XIII, Neni 71, Pika 2 | Pika 2 e nenit 70 zbatohet edhe në këtë rast. | | |
| Kreu XIII, Neni 71, Pika 3 | Përveç zbatimit të dënimit administrativ, sipas pikës 1 të këtij neni, institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë informon për shkeljet e konstatuara edhe njësinë arsimore | | |

| | | | |
|--|---|--|--|
| | vendore përkatëse. | | |
| Kreu XIV, Neni 72, Pika 3 | Institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore private plotësuese, të licencuara përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për lejet, licencat dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë”, dhe ato të licencuara me ligjin e sipërpërmendur, kanë përshtatur dokumentacionin e organizimit dhe të funksionimit institucional, si dhe atë mësimor, në përputhje me këtë ligj, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. | | |
| Kreu XIV, Neni 72, Pika 5 | Personeli mësimdhënës, që është i punësuar me kontratë të përhershme dhe ka formimin përkatës universitar, ka ruajtur vendet e punës dhe u është nënshtruar trajnimeve për përditësimin e dijeve që lidhen me profesionin. Ky përcaktim vlen edhe për mësuesit që kanë përfunduar arsimin e lartë pedagogjik 3-vjeçar, përpara hyrjes në fuqi të sistemit të Bolonjës. Personeli mësimdhënës, që është i punësuar me kontratë të përhershme dhe që ka mbaruar një shkollë të mesme pedagogjike ose shkollë tjetër të profilizuar për mësuesi, siç janë shkollat e mesme të muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja dhe fizkulturës, dhe që ka fituar tri shkallët e kualifikimit, ka ruajtur vendet e punës dhe u është nënshtruar trajnimeve për përditësimin e dijeve që lidhen me profesionin. | | |
| Kreu XIV, Neni 72, Pika 6 (i # me 48/20) | Personelit mësimdhënës, që ka përfunduar studimet universitare në ish-institutet e larta pedagogjike, diploma e përfituar i është njohur si arsim i lartë, tetë semestra, për efekt page. | | |